



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

REGULLORE PËR SISTEMIN E GARAVE

PRISHTINË 2026

Në përputhje me nenin 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës, Federata e Pingpongut e Kosovës, në mbledhjen e datës: 09/03/2026 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SISTEMIN E GARAVE TË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË KOSOVËS

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim caktimin e sistemit të garave të pingpongut të Federatës së Pingpongut të Kosovës (FPPK), për të gjitha kategoritë e pingpongistëve, duke përfshirë kampionatin ekipor, kampionatet dhe turnetë individuale, Kupën e Kosovës, turnetë e hapura dhe të ftuara, si dhe mënyrën e përpilimit të ranglistave dhe organizimin e shortit

Neni 2 Llojet dhe tipi i garave

1. Garat e pingpongut sipas kësaj Rregullore ndahen në zyrtare dhe jozyrtare.
 - 1.1. Garat zyrtare përbëjnë bazën për kategorizimin e klubeve dhe sportistëve në ranglistat e FPPK - së.
 - 1.2. Garat jozyrtare janë ato që nuk përfshihen në këtë Rregullore, si takimet miqësore, stërvitore, apo garat me karakter argëtues dhe promovues.
2. Garat mund të jenë të tipit të hapur ose të mbyllur:
 - 2.1. Të hapura: ku të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjitha klubet e regjistruara në FPPK dhe sportistët individualë në pajtim me nenin 9.
 - 2.2. Të mbyllura: ku të drejtë pjesëmarrjeje kanë vetëm klubet dhe sportistët që e kanë fituar këtë të drejtë duke plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 3 Të drejtat dhe detyrat e klubeve dhe sportistëve

1. Është e drejtë e klubeve dhe sportistëve të marrin pjesë në garat e organizuara nga FPPK.
2. Është detyrë e klubeve dhe sportistëve që të respektojnë kalendarin e garave, rregullat e lojës dhe vendimet e organeve kompetente të FPPK - së.
3. Mos - pjesëmarrja e paarsyeshme në garat e përcaktuara zyrtarisht, posaçërisht kur është bërë paraqitja për pjesëmarrje, mund të sjellë pasoja disiplinore sipas vendimeve të komisioneve përkatëse.
4. Klubet dhe sportistët kanë të drejtë të marrin informacione të plota, të barabarta dhe transparente për garat, si dhe të kërkojnë sqarime nga organet e FPPK - së për çdo procedurë që lidhet me pjesëmarrjen.

Neni 4 Kalendarin e garave

1. Para fillimit të çdo viti garues përpilohet kalendarin e garave, i cili përcakton:
 - 1.1. vendin dhe kohën e mbajtjes së garave të parapara nga kjo Rregullore;
 - 1.2. paraqitjet e përzgjedhjes, si dhe turnetë përkujtimor dhe promovues të cilët Bordi Ekzekutiv i vlerëson si të rëndësishëm për zhvillimin dhe popullarizimin e pingpongut.
2. Propozimi i kalendarit duhet të përgatitet çdo vit jo më vonë se 1 shkurti.
3. Hartimi i kalendarit bëhet nga Komisari i Garave, duke u konsultuar me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Përfaqësueses. Pas shqyrtimit nga Bordi Ekzekutiv, kalendarin u dërgohet klubeve për komente dhe propozime shtesë. Pas përfundimit të konsultimeve, Bordi Ekzekutiv e procedon kalendarin për miratim në Kuvend. Ndryshimet dhe plotësimet gjatë vitit bëhen me vendim të Bordit Ekzekutiv.
4. Kalendarin e miratuar publikohet brenda tre ditëve në faqen zyrtare të FPPK - së dhe shpërndahet tek klubet dhe anëtarët e FPPK - së.

Neni 5 - Llojet e garave

1. Garat e pingpongut në Kosovë janë gara individuale dhe ekipore, duke u ndarë edhe sipas:
 - 1.1. Kategorisë - bazuar në grupmoshat e sportistëve;
 - 1.2. Nivelit - bazuar në shkallën e garës (komunale, kampionale, ndërkombëtare);
 - 1.3. Gjinisë - garat zhvillohen veçmas për meshkuj dhe femra.
2. Rregullat e hollësishme për secilën ndarje përcaktohen në nenet 6, 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6 Garat sipas kategorisë

1. Garat zyrtare sipas kategorisë mbështeten në moshën e sportistëve dhe mbahen për të dy gjinitë sipas këtyre grupmoshave :
 - Senior
 - U21
 - U19
 - U17
 - U15
 - U13
 - U11
2. Garat jozyrtare mbahen në kategoritë:
 - U9 - Shpresat
 - Veteranët (40+ vjeç, të ndarë në grupmosha mbi 40, mbi 50, mbi 60, mbi 65, mbi 70, mbi 75; me kusht që grupmosha të ketë së paku 5 sportistë, përndryshe bashkohet me grupmoshën më të re).
3. Rregulla të përgjithshme për pjesëmarrjen:
 - Në garat ekipore të seniorëve mund të paraqiten të gjithë sportistët e regjistruar në FPPK, pa marrë parasysh moshën.
 - Në garat individuale të seniorëve mund të marrin pjesë vetëm sportistët mbi 16 vjeçar, Përrjashtimisht, sportistët më të rinj se 16 vjeç mund të marrin pjesë në garat individuale të seniorëve, nëse janë të renditur në top 4 të ranglistës së kategorisë U15.
 - Në kategorinë U21, pjesëmarrja në garat individuale lejohet për sportistët mbi moshën 14 vjeçare; përjashtimisht, mund të marrin pjesë edhe sportistët më të rinj, nëse janë të renditur në top 4 të ranglistës U13.
 - Në kategorinë U19, pjesëmarrja në garat individuale lejohet për sportistët mbi moshën 12 vjeçare; përjashtimisht, mund të marrin pjesë edhe sportistët më të rinj, nëse janë të renditur në top 4 të ranglistës U11.
 - Në kategorinë U17, pjesëmarrja në garat individuale lejohet për sportistët mbi moshën 10 vjeçare; përjashtimisht, mund të marrin pjesë edhe sportistët më të rinj, nëse janë të renditur në top 4 të ranglistës U9.
 - Në kategorinë U15, të drejtë pjesëmarrjeje kanë sportistët që deri më 1 janar të vitit që zhvillohet gara nuk i kanë mbushur 15 vjet.
 - Në kategorinë U13, të drejtë pjesëmarrjeje kanë që deri më 1 janar të vitit që zhvillohet gara nuk i kanë mbushur 13 vjet.
 - Në kategorinë U11, të drejtë pjesëmarrjeje kanë sportistët që deri më 1 janar të vitit që zhvillohet gara nuk i kanë mbushur 11 vjet.
 - Në kategorinë U9, të drejtë pjesëmarrjeje kanë sportistët që deri më 1 janar të vitit që zhvillohet gara nuk i kanë mbushur 9 vjet
4. Caktimi i kategorisë sipas moshës

Sportisti/ja i takon kategorisë së grupmohës përkatëse nëse nuk e arrin kufirin e moshës së asaj kategorie deri më 31 dhjetor të vitit kalendarik para vitit në të cilin zhvillohet gara.

Neni 7 Garat sipas nivelit

1. Garat zyrtare sipas nivelit ndahen në:
Niveli I - Garat komunale
Niveli II - Garat kampionale
Niveli III - Garat ndërkombëtare
2. Garat e nivelit I kanë karakter të hapur dhe masivizues. Në to mund të marrin pjesë ekipet dhe sportistët e klubeve, sportistët e organizatave punuese, shkollave, si dhe çdo sportist që paraqitet për pjesëmarrje.
3. Garat individuale dhe ekipore të nivelit II, sipas rregullit, janë të tipit të mbyllur. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë anëtarët e FPPK - së, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
4. Garat e nivelit III organizohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare. Propozicionet e garave ndërkombëtare përcaktojnë të drejtën e pjesëmarrjes, mënyrën e zhvillimit të ndeshjeve, udhëheqjen e garës, aspektet materiale dhe çdo element tjetër të rëndësishëm për organizimin e saj.

Neni 8 Garat sipas gjinisë

1. Në të gjitha kategoritë dhe nivelet e garave zhvillohen gara të ndara për meshkuj dhe për femra.
2. Sportistët nuk mund të garojnë në konkurrencën e gjinisë tjetër.
3. Përrjashtimisht, në garat e nivelit I (komunale), femrat mund të marrin pjesë edhe në konkurrencën e meshkujve.

Neni 9 Pjesëmarrja në gara individuale dhe ekipore

1. Garat ekipore
 - Në garat ekipore mund të marrin pjesë të gjitha klubet e regjistruara në FPPK.
2. Kampionatet individuale të Kosovës
 - Pikëzohen për ranglistën e FPPK - së.
 - Në këto gara kanë të drejtë pjesëmarrjeje vetëm sportistët shtetas të Kosovës të regjistruar në FPPK.
3. Turnetë e hapur dhe memorialë
 - Turnetë që organizohen nga FPPK e të cilat pikëzohen për ranglistën e FPPK - së.
 - Në këto Turne kanë të drejtë pjesëmarrjeje sportistët vendorë të regjistruar në FPPK si dhe sportistë të huaj, pavarësisht nëse janë apo nuk janë të regjistruar në FPPK.
4. Top 8 turnetë
 - Në këto gara marrin pjesë vetëm 8 sportistët më të mirë të renditur në ranglistën e FPPK - së, pavarësisht shtetësisë, por që janë të regjistruar në FPPK.
 - Pikëzohen për ranglistën e FPPK - së.
 - Përrjashtimisht, Drejtori i Përfaqësueses ka të drejtë të ftojë 1 (një) deri në 2 (dy) sportistë të regjistruar në FPPK, të cilët nuk kanë pikë të mjaftueshme për t'u renditur në Top 8 e kategorisë përkatëse, por që vlerësohen si me interes për garën.

Neni 10 Rregullat për sportistët

1. Një sportist mund të jetë i regjistruar vetëm për një klub.
2. Sportistët e kategorive më të reja mund të marrin pjesë në garat ekipore të kategorive më të vjetra, por nuk mund të paraqiten në dy grupmosha brenda të njëjtës dite.
3. Në garat individuale, sportistët kanë të drejtë të paraqiten vetëm në një grupmoshë brenda një dite.

Neni 11 Zbatimi i rregullave

1. FPPK zbaton rregullat e pingpongut të përcaktuara nga ITTF (Handbook, Kreu 2).
2. Të gjitha garat e organizuara nga FPPK zhvillohen në pajtim me këtë Rregullore dhe Rregulloren për organizimin e garave të FPPK - së.
3. Garat ndërkombëtare të organizuara në Kosovë zhvillohen në pajtim me rregullat e ITTF - it dhe ETTU - së, të cilat kanë përparësi ndaj rregulloreve vendore kur ka mospërputhje.

Neni 12 Zhvillimi i ndeshjeve ekipore

1. Të gjitha ndeshjet ekipore zhvillohen sipas njërit prej sistemeve të përcaktuara në Handbook të ITTF për garat ekipore, me ndryshimet e aprovuara nga Bordi ose Kuvendi i FPPK - së.
2. Sistemet e miratuara për garat ekipore janë:
 - Sistemi 1 - Kupës Swaythling (New Swaythling Cup):
5 ndeshje individuale (A - X, B - Y, C - Z, B - X, A - Y).
Fiton skuadra që arrin 3 fitore.
Ekipi përbëhet prej 3 sportistësh.
Përbërja caktohet me short, përveç kur ekipet takohen dy herë - mikpritësi ka përbërjen ABC.
 - Sistemi 2 - Kampionati Evropian (C European Championships):
5 ndeshje individuale (A - X, B - Y, C - Z, B - X, A - Y).
Fiton skuadra që arrin 3 fitore.
Ekipi përbëhet prej 3 - 4 sportistësh.
Para lojës së tretë, kapiteni mund të aktivizojë sportistin rezervë dhe ta vendosë në pozitat A/B (vendas) ose X/Y (mysafir).
 - Sistemi 3 - Me 4 fitore:
7 ndeshje (A - Y, B - X, C - Z, çiftet, A - X, C - Y, B - Z).
Fiton skuadra që arrin 4 fitore.
Ekipi përbëhet prej 3 - 5 sportistësh.
Rezervat mund të përdoren para lojës së çifteve.
 - Sistemi 4 - Olimpik (Olympic system):
5 ndeshje (A - X, B - Y, çiftet (B&C - Y&Z), A - Z, C - X)
Fiton skuadra që arrin 3 fitore.
Ekipi përbëhet prej 3 sportistësh, secili sportist mund të zhvillojë maksimum 2 ndeshje.
 - Sistemi 5 - Me 4 fitore (variant i zgjeruar):
7 ndeshje (A - Y, B - X, C - Z, çiftet, A - X, C - Y, B - Z).
Fiton skuadra që arrin 4 fitore.
Ekipi përbëhet prej 4 - 5 sportistësh.
Çdo sportist mund të luajë maksimum 2 ndeshje.
Rezervat mund të përdoren para lojës së çifteve.
 - Sistemi 6 - Olimpik (variant i shkurtuar):
5 ndeshje (A - X, B - Y, Çiftet, B - X, A - Y)
Fiton skuadra që arrin 3 fitore.
Ekipi përbëhet prej 2 - 4 sportistësh.

Rezervat mund të përdoren para lojës së çifteve.

Neni 13 - Setat dhe pikët

1. Të gjithë setat luhen në 11 pikë të fituara. Në rast barazimi 10 - 10, loja vazhdon derisa një sportist të fitojë me diferencë prej dy pikësh.
2. Të gjitha ndeshjet e çifteve luhen në 3 seta të fituar.
3. Të gjitha takimet në garat ekipore luhen në 3 seta të fituar, përveç rasteve kur ITTF përcakton ndryshe.
4. Të gjitha garat individuale luhen në 3 seta të fituar, me përjashtim të:
 - 4.1 Kampionatit individual të seniorëve, ku nga faza e çerekfinales deri në përfundim ndeshjet zhvillohen në 4 seta të fituar.

Neni 14 - Kualifikimet në grupe dhe kalimi në sistem eliminues

1. Kur garës individuale ose ekipore me sistem eliminues i paraprijnë kualifikimet nëpër grupe:
 - Nëse janë 8 ose më pak grupe, kualifikohen dy të parët e secilit grup.
 - Nëse janë më shumë se 9 grupe, kualifikohet vetëm fituesi i grupit.
2. Çdo grup përbëhet nga 3 - 5 sportistë ose ekipe, të cilët takohen ndërmjet vete sipas sistemit “secili me secilin”.
3. Plasmani në grup përcaktohet sipas mënyrës së vërtetuar në Nenin 21 të kësaj Rregulloreje.

Neni 15 - Renditja në garat me sistem secili me secilin

1. Në garat ekipore dhe individuale të zhvilluara me sistemin “secili me secilin”, renditja e sportistëve ose ekipeve përcaktohet në bazë të rezultateve të arritura në ndeshjet e luajtura. Në mënyrë që të sigurohet një klasifikim i drejtë dhe transparent, çdo ndeshje llogaritet me pikë, si në vijim:
 - Fitorja me 2 pikë
 - Humbja me 1 pikë
 - Ndeshje e pa luajtur ose e papërfunduar me 0 pikë
2. Kur dy ose më shumë ekipe/sportistë kanë numër të njëjtë pikësh, renditja përcaktohet nga rezultatet e takimeve të ndërsjella, sipas këtij rendi:
 - numri i pikëve të fituara,
 - numri i fitoreve dhe humbjeve në duelet individuale,
 - setet e fituara dhe të humbura,
 - pikët e fituara dhe të humbura brenda seteve.
3. Nëse pas zbatimit të kriterëve të mësipërme është përcaktuar vendi i një ose më shumë ekipeve/sportistëve, ndërsa të tjerët mbeten të barabartë, procedura përsëritet duke marrë parasysh vetëm rezultatet e atyre që kanë mbetur të barabartë.

Neni 16 - Kufizimet e pjesëmarrjes ditore të sportistëve

1. Në pajtim me standardet e vërtetuara mjekësore dhe për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të sportistëve, përcaktohen kufijtë maksimalë të ndeshjeve që një sportist mund të zhvillojë brenda një dite, në varësi të kohëzgjatjes së garës dhe formatit të saj.
 - 1.1. Në garat ekipore
 - Deri në fitoren e katërt të një ekipi:
 - Ora 9 - 14 (5 orë) - maksimum 6 ndeshje

- Ora 16 - 21 (5 orë) - maksimum 6 ndeshje
- Ora 9 - 21 (12 orë) - maksimum 8 ndeshje

1.2. Në garat individuale

- Në garat infivduale që zhvillohen me 4 seta të fituar:
 - Ora 9 - 14 (5 orë) - maksimum 4 ndeshje
 - Ora 16 - 21 (5 orë) - maksimum 4 ndeshje
 - Ora 9 - 21 (12 orë) - maksimum 6 ndeshje
 - Në garat individuale që zhvillohen me 3 seta të fituar:
 - Ora 9 - 14 (5 orë) - maksimum 6 ndeshje
 - Ora 16 - 21 (5 orë) - maksimum 6 ndeshje
 - Ora 9 - 21 (12 orë) - maksimum 8 ndeshje
2. Për turnetë njëditorë me kohëzgjatje më shumë se 7 orë, sportistëve duhet t'u sigurohet pushim prej së paku 2 orësh.

Neni 17 - Pjesëmarrja e klubeve në garat e nivelit III

1. Për të siguruar barazi dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet klubeve, në garat e nivelit III çdo klub ka të drejtë të marrë pjesë vetëm me:
- një ekip të meshkujve, dhe
 - një ekip të femrave.

Neni 18 - Shorti i garave

1. Shorti për garat ekipore dhe individuale është një element i rëndësishëm për garantimin e transparencës dhe barazisë në garë.
2. Shortin për garat ekipore e propozon Komisioni i Garave të FPPK - së, bazuar në rregullat e përcaktuara dhe praktikatat e miratuara ndërkombëtare.
3. Propozimi i shortit nga Komisioni i Garave i paraqitet Bordit të FPPK - së për verifikim dhe rekomandim.
4. Shorti aprovet nga Kuvendi i FPPK - së, si organi më i lartë vendimmarrës.
5. Shorti i garave individuale përgatitet nga Komisioni i Garave. Procesi i hedhjes së shortit është i hapur për të gjithë të interesuarit dhe publikohet në mënyrë transparente. Në rast të ankesave të arsyeshme, brenda 24 orësh nga publikimi, Komisioni i Garave shqyrton rastin dhe bën përmirësimet e nevojshme

Neni 19 - Përcaktimi i bartësve

1. Për çdo garë, gjatë hedhjes së shortit, caktohen bartësit
2. Numri i bartësve përcaktohet sipas llojit të garës (faza eliminuese ose faza e grupeve) dhe sipas numrit të garuesve.
3. Për caktimin e bartësve në garat individuale nëse nuk ka sportist të huaj të paraqitur, merret për bazë ranglista aktuale e FPPK-së, në rast se ka sportist të huaj, për bazë merret ranglista e ITTF-it.
4. Në garat ekipore në ligat që vazhdojnë nga viti i kaluar, 4 të parët vendosen sipas radhitjes që kanë pas në fund të vitit të kaluar, ndërsa për të tjerët fillimisht shikohet që klubet që kanë marrëdhëniet e mira me 4 bartësit të i zhvillojnë ndeshjet në fillim të sezonit, e pastaj shikohet radhitja nga fundviti të kaluar. Klubet e reja që hyjnë nga një rang më i ulët zakonisht vendosen në pozitat e fundit.

5. Në rast se një ligë formohet për herë të parë Bartësit caktohen duke marrë për bazë pikët e sportistëve të klubeve në ranglistën aktuale të FPPK - së. Pikët ranguese të një individi caktohen sipas tabelës:
 - Vendi 1 - 2 - 25 pikë
 - Vendi 3 - 4 - 20 pikë
 - Vendi 5 - 8 - 15 pikë
 - Vendi 9 - 16 - 10 pikë
 - Vendi 17 - 32 - 5 pikë
 - Vendi 33 - 64 - 3 pikë
 - Vendi 65 - 128 - 1 pikë
6. Në rast se dy ose më shumë ekipe kanë renditje të njëjtë, më i mirë konsiderohet ekipi që ka sportistin e parë më mirë të plasuar në ranglistën aktuale.
7. Bartësit në lojën e çifteve (meshkuj dhe femra) caktohen duke mbledhur pikët e çiftit sipas ranglistave përkatëse për meshkuj e femra.

Neni 20 – Vendosja e bartësve në garat me sistem eliminues

1. Vendosja e bartësve bëhet sipas skeletit standard të garave ndërkombëtare:
 - 1.1. Bartësi i parë vendoset në fillim të skeletit, kurse i dyti në fund të skeletit.
 - 1.2. Bartësi i 3 dhe i 4 caktohen me short në fund të gjysmës së parë dhe në fillim të gjysmës së dytë të skeletit.
 - 1.3. Bartësit 5–8 caktohen me short në pozitat e çerekut përkatës.
 - 1.4. Bartësit 9–16 caktohen me short në pozitat e tetës përkatëse.
 - 1.5. Bartësit 17–32 caktohen me short në pozitat e gjashtëmbëdhjetës përkatëse
 - 1.6. Bartësit 33–64 caktohen me short në pozitat e tridhjetë e dytës përkatëse
 - 1.7. Vendosja e bartësve vazhdon në të njëjtën mënyrë edhe përtej numrit 65.

Neni 21 – Vendosja e bartësve në garat me sistem grupe

1. Kur gara ose para-gara zhvillohet në grupe, në çdo grup caktohet bartësi; nëse janë 8 ose më pak grupe caktohen edhe nën bartësit.
2. Fituesit e grupeve konsiderohen si bartës dhe me short vendosen në pozitat e skeletit që u përkasin kategorive përkatëse të bartësve.
3. Nëse janë 8 ose më pak grupe, sportisti i dytë në grup vendoset me short në pozitat e lira të skeletit, me kusht që në xhiron e parë të mos takohen sportistët që kanë luajtur në të njëjtin grup.

Neni 22 – Përgatitja e shortit

1. Në TOP 8 turnetë, si dhe në grupe, shorti përgatitet duke pasur parasysh që sportistët e klubit të njëjtë të takohen në fillim të garës, ndërsa sportistët më të mire të mos takohen deri në ndeshjet finale.
2. Në garat me sistem eliminues shorti përgatitet duke pas parasysh që sportistët e klubit të njëjtë nuk mund të takohen në xhiron e parë, e mundësisht të mos takohen deri në të tetën e finales.

Neni 23 – Ndryshimi i shortit

1. Shorti i tërhequr njëherë sipas rregullit nuk mund të ndërrohet.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1, ndryshim në short mund të bëhet vetëm në rastet:
 - 2.1. Kur vërtetohet se është bërë gabim në tërheqjen e shortit;

- 2.2. Kur mungesa e numrit më të madh të bartësve çrregullon seriozisht baraspeshën në skelet, për ç'rast Komisioni i Garave vendos:
- për tërheqje të serishme të shortit;
 - që të bëhet tërheqje e re vetëm për bartësit;
 - ose që të pranohet gjendja ekzistuese.
- 2.3. Nëse gjatë garës prishet baraspesha numerike e sportistëve në grupe, Komisioni i Garave, me short, e baraspeshon grupin pa prekur bartësit e grupit.

Neni 24 – Organizimi dhe struktura e ligave

1. Garat ekipore në Ligat e Kosovës organizohen sipas strukturës së përcaktuar nga FPPK.
2. Hierarkia e ligave për të dy gjinitë është:
 - a. Superliga
 - b. Liga e parë
 - c. Liga e dytë
 - d. Liga regjionale
3. Nëse një ligë ka deri në 11 klube, ajo zhvillohet si një ligë e vetme.
4. Nëse një ligë ka 12 ose më shumë klube, ajo ndahet në dy grupe me nga së paku 6 ekipe.
5. Numri i ekipeve në një ligë nuk bën të jetë më i madh se 12 dhe nuk bën të jetë më i vogël se 5; preferohet që një ligë të ketë 8 ekipe.
6. Përjashtim nga pika 4 lejohet në Ligën regjionale, në të cilën mund të ketë më shumë ekipe; këto ndahen sipas regjionit, por gjithmonë duke respektuar kufizimin e pikës 5.
7. Gara ekipore zhvillohet në dy stinorë: pranveror dhe vjeshtor.
8. Kampione shpallet skuadra që renditet e para në fund të kampionatit, ndërsa dy ekipet e fundit largohen nga liga.
9. Me vendim të Bordit në fillim të vitit mund të shtohen ndeshjet e playoff-it dhe play-out-it, sipas formatit të përcaktuar për atë sezon

Neni 25 – Plotësimi i ligave

1. Çdo ligë plotësohet duke kaluar drejtpërdrejt dy ekipet e para nga liga më e ulët përkatëse.
2. Me vendim të Bordit, mund të organizohet ndeshja e barazhit ndërmjet ekipit të parafundit të ligës më të lartë dhe ekipit të dytë të ligës më të ulët, për të përcaktuar klubin që do të vazhdojë garat në ligën më të lartë.
3. Formatet e barazhit përcaktohen çdo vit nga Bordi, sipas numrit të ekipeve dhe strukturës së ligave.

Neni 26 – Organizimi i garave në Ligat e Kosovës

1. Me garat në Ligat e Kosovës udhëheq Komisioni i regjistrimit dhe Garave, i cili emërohet nga Bordi i FPPK-së.
2. Të gjitha shpenzimet e organizimit dhe zhvillimit të garave i mbulojnë klubet pjesëmarrëse të ligës, përveç rasteve kur Bordi merr vendim tjetër.

Neni 27 – Kupa e Kosovës

1. Në garat për Kupën e Kosovës mund të marrin pjesë vetëm klubet e regjistruara nga Kosova.
2. Me kushte të njëjta mund të marrin pjesë edhe përbërjet e organizatave punuese, shkollave dhe përfaqësuesit e shoqatave të tyre.
3. Një sportist mund të jetë i paraqitur dhe të luajë vetëm për një klub.

4. Kupa e Kosovës zhvillohet me sistem eliminues deri në fund.
5. Garat në një kategori organizohen vetëm nëse paraqiten 4 ose më shumë klube.
6. Në garat e Kupës inkuadrohen edhe ekipet e ligave të Kosovës, sipas strukturës së përcaktuar nga FPPK.
7. Kupa e Kosovës organizohet për të dy gjinitë dhe për të gjitha grupmoshat, nëse plotësohet kufizimi i pikës 5.
8. Në një grupmoshë një klub mund të paraqesë vetëm një ekip të së njëjtës gjini.
9. Bartësit caktohen sipas renditjes finale të Superligës; për klubet tjera vendet në skelet plotësohen me short.
10. Fitues i Kupës së Kosovës shpallet klubi që i mund të gjithë kundërshtarët e tij në sistemin eliminues.

Neni 28 – Kampionati individual i Kosovës

1. Kampionati i Kosovës është gara kryesore individuale për sportistët e regjistruar në FPPK.
2. Në kampionat mund të marrin pjesë vetëm sportistët e regjistruar nga Kosova.
3. Kampionati organizohet për të gjitha garat zyrtare të parapara në këtë rregullore dhe për të dy gjinitë.
4. Garat individuale zhvillohen në dy faza: faza e grupeve dhe faza eliminatore.
5. Disiplinat e kampionatit përfshijnë garat individuale dhe garat e çifteve, përfshirë edhe çiftet e përziera në grupmoshën e seniorëve, U15 dhe U19.

Neni 29 – Top turnetë e Kosovës

1. Top turnetë bazohen në grupmoshat e garave zyrtare, me qëllim demonstrimin e cilësisë, promovimin medial dhe avancimin e pingpongut, si dhe për çështje marketingu.
2. Top turnetë mund të organizohen me 8 ose 12 pjesëmarrës. Në këto turne, të gjithë sportistët takohen ndërmjet vete.
3. Turnetë zhvillohen gjatë një ose dy ditëve, sipas formatit:
 - 2–3–2 me 8 sportistë
 - 3–4–4 me 12 sportistë
4. Në turnetë me 8 sportistë marrin pjesë 6 sportistët më të mirë sipas ranglistës për vitin rrjedhës dhe 2 sportistë të ftuar nga Drejtori i Përfaqësueses.
5. Në turnetë me 12 sportistë marrin pjesë 9 sportistët më të mirë sipas ranglistës rrjedhëse të FPPK-së dhe 3 sportistë të ftuar nga Drejtori i Përfaqësueses.
6. Nëse Drejtori i Përfaqësueses nuk e shfrytëzon të drejtën e tij, ose e shfrytëzon pjesërisht, numri i pjesëmarrësve plotësohet me sportistë sipas ranglistës.

Neni 30 – Turnetë e ftuar

1. Turnetë e ftuar bazohen në ftesë dhe kanë për qëllim: a. Vërtetimin e formës dhe cilësisë së sportistëve, veçanërisht kandidatëve për përzgjedhje. b. Dhënien e mundësisë për fitimin e përvojës dhe përsosurisë sportive, duke luajtur më shumë ndeshje me kundërshtarë të barabartë.
2. Turneu i ftuar organizohet me 12 pjesëmarrës.
3. Sportistët ndahen në dy grupe me nga 6, ku secili luan me secilin brenda grupit.
4. Në fazën përfundimtare formohen tri grupe me nga 4 sportistë, sipas plasmanit në grupe:
 - Grupi A: vendet 1 dhe 2 – luhet për Vendin 1–4
 - Grupi B: vendet 3 dhe 4 - luhet për Vendin 5–8
 - Grupi C: vendet 5 dhe 6 - luhet për Vendin 9–12
5. Rezultatet e ndërsjella nga lojërat në grupe llogariten edhe në fazën përfundimtare.

6. Turnetë zhvillohen brenda një dite.
7. Përbërja e turneut të parë të ftuar për të gjitha kategoritë e garuesve është:
 - a. 6 sportistët më të mirë të plasuar sipas ranglistës përfundimtare të FPPK-së nga stinori i kaluar.
 - b. 3 sportistët më të mirë nga turneu i hapur klasifikues me të cilin lidhet.
 - c. 3 sportistët të ftuar nga Drejtori i Përfaqësueses.

Neni 31 – Turnetë e hapur kualifikues

1. Turnetë e hapur kualifikues organizohen për të gjitha kategoritë e garuesve dhe përbëjnë një tërësi me turnetë e ftuar, me të cilët janë të lidhur.
2. Turnetë e hapur kualifikues zhvillohen sipas formatit të turneve të hapur, me këto kufizime:
 - a. Në turneun e parë të hapur kualifikues nuk mund të marrin pjesë sportistët që kanë fituar të drejtën për të luajtur në turneun e ftuar në bazë të ranglistës përfundimtare të vitit paraprak.
 - b. Në turneun e dytë ose në turnetë e tjerë eventuale të hapur kualifikues nuk mund të marrin pjesë sportistët që kanë fituar të drejtën për të luajtur në turneun e ftuar në bazë të renditjes në turneun e parë ose të dytë.
 - c. Në bazë të plasmanit të arritur në turneun e hapur kualifikues, 3 sportistët më të mirë fitojnë të drejtën për të luajtur në turneun e ftuar me të cilin është i lidhur turneu i hapur kualifikues.
3. Rezultatet e arritura në turneun e hapur kualifikues pikëzohen për renditjen në ranglistën e FPPK-së.
4. Sportistëve që janë kualifikuar për turneun e ftuar u llogariten pikët ose nga turneu i ftuar ose nga turneu i hapur kualifikues, cilido që të jetë më i përshtatshëm për ta.

Neni 32 – Turnetë e hapur

1. Me qëllim që t'u ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së vazhduar në gara, mund të organizohen turne të hapur për të gjitha kategoritë e garuesve.
2. Në turnetë e hapur, në pajtim me rregullat dhe propozicionet e kësaj Rregulloreje, mund të marrin pjesë të gjithë sportistët e paraqitur.
3. Rezultatet e arritura në turnetë e hapur pikëzohen dhe llogariten për ranglistën e FPPK-së.

Neni 33 – Ranglistat

1. Suksesit e secilit sportist brenda FPPK-së vërtetohet me pozitën e tij në ranglistë.
2. Ranglistat hartohen për stinorin garues, ndërsa gjatë stinorit përditësohen ranglistat aktuale.
3. Mënyra e vlerësimit të rezultateve të arritura zbatohet në përputhje me Rregulloren për hartimin e ranglistës së Federatës së Pingpongut të Kosovës.
4. Rezultatet nga të gjitha garat zyrtare, përfshirë turnetë e hapur, turnetë e ftuar dhe kampionatet, merren parasysh për pikëzimin dhe renditjen e sportistëve.

Neni 34 – Përfaqësuesja e Kosovës

4. Të përzgjedhurit e pingpongut të Kosovës përfaqësojnë, si individë apo si ekip, FPPK-në, sportin e pingpongut dhe Kosovën në garat ndërkombëtare.
5. Për ekipin e përzgjedhjes mund të paraqiten sportistë shtetas të Kosovës, të regjistruar në klubet e Kosovës ose në klube jashtë kufijve të saj.
6. Caktimi i të përzgjedhurve për të përfaqësuar Kosovën në garat ekipore ose individuale ndërkombëtare bëhet në përputhje me: a. Statutin e FPPK-së b. Rregulloren e punës së Ekipit Përfaqësues të Kosovës c. Planin profesional të punës së Drejtorit të Përfaqësueses

Neni 35 – Dispozitat përfundimtare


1. Komisioni i Garave është autoriteti kompetent për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.
2. Të gjithë anëtarët e FPPK-së, sportistët dhe pjesëmarrësit e paraqitur për pjesëmarrje dhe të përfshirë në aktivitetet e Federatës, i nënshtrohen dispozitave të kësaj Rregulloreje.
3. Vendimet e Komisionit të Garave dhe Bordit të FPPK-së në zbatim të kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për të gjitha klubet dhe sportistët.

Neni 36 – Ndryshimet e sistemit të garave

4. Bordi i FPPK-së mund t'i propozojë Kuvendit të FPPK-së që disa gara të organizohen ndryshe nga mënyra e paraparë me këtë Rregullore.
5. Kuvendi ka të drejtën të miratojë ndryshimin e sistemit të garave, dhe vendimi i tij bëhet pjesë integrale e kësaj Rregulloreje.
6. Çdo vendim i Kuvendit për ndryshimin e sistemit të garave publikohet zyrtarisht nga FPPK dhe hyn në fuqi nga data e përcaktuar në vendim.
7. Ndryshimet e miratuara nga Kuvendi janë të detyrueshme për të gjitha klubet dhe sportistët pjesëmarrës në garat e FPPK-së.

Neni 37 – Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i FPPK-së.
2. Rregullorja publikohet në faqen zyrtare të Federatës dhe konsiderohet e detyrueshme për të gjitha klubet dhe sportistët nga dita e publikimit.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për sistemin e garave e vitit 2024.
4. Çdo dispozitë e kësaj Rregulloreje zbatohet menjëherë pas hyrjes në fuqi, përveç rasteve kur Kuvendi i FPPK-së përcakton ndryshe.


JETON ORUQI

Kryetar i Federatës së Pingpongut të Kosovës

Prishtinë,
09/03/2026